

Tonin Tarnaku - Një falenderim i vonuar për Nino Saraçin

Contributed by Jozef Martini
Tuesday, 14 April 2015

Një falenderim i vonuar për Nino Saraçin

Tonin Tarnaku

p.MsoNormal, li.MsoNormal, div.MsoNormal { margin: 0cm 0cm 0.0001pt; font-size: 12pt; font-family: "Times New Roman", "serif"; } p.MsoFootnoteText, li.MsoFootnoteText, div.MsoFootnoteText { margin: 0cm 0cm 0.0001pt; font-size: 10pt; font-family: "Times New Roman", "serif"; } span.MsoFootnoteReference { vertical-align: super; } span.TestonotaapidipaginaCarattere { }.MsoChpDefault { font-size: 10pt; } div.WordSection1 { page: WordSection1; }

Një falenderim i vonuar

Tonin Tarnaku

Tek shkruaj këto kujtime për mësuesin tim të nderuar zotni Nino Saraçin, rikthehem pas në vitet e fëmijërisë, në vitet e fillimit të shkollimit tim muzikor.

Mësuesi im i parë i muzikës ka qenë Çesk Ndreca, daja im. Duke vërejtur interesin tim për muzikën që shfaqej në forma të ndryshme, familja ime i kishte kërkuar dajës që të verifikonte nëse kisha prirje dhe të jepte ndonjë mendim për këtë. Daja jo vetëm që konstatoi me kënaqësi që kisha muzikalitet, por edhe u angazhua që të më jepte mësim.

Ndoshta ndokush prej lexuesve emrin e Çesk Ndreçës e lidh me atë të autorit të teksteve të disa këngëve të njohura të muzikuara nga Mark Kaftalli si “Ndal vashë”, “Lule t’bukra sjell pranvera”, etj. Po, është e vërtetë që daja ka shkruar tekste por përveç veprimtarisë në këtë drejtim ishte edhe muzikant. I binte fizarmonikës dhe kitarrës, në Orkestrën Sinfonike të Shtëpisë së Kulturës të qytetit i kishte rënë fagotit dhe kontrabasit. Edhe pse nuk ishte muzikant profesionist, daja Çesk e njihte mirë muzikën dhe ishte mësues rigoroz dhe metodik.

Më kujtohet që në bibliotekën e tij ruante me xheloz një libër me kapakë të fortë që na e tregonte duke thënë si me mburrje «Ma ka dhanë vetë Preka». Libri në fjalë ishte një metodë fagoti e një autori sovjetik. Kompozitori i mirënjohur njëkohësisht dirigjenti i orkestrës sinfonike të qytetit Prenkë Jakova gjatë një vizite në Bashkimin Sovjetik kishte grumbulluar metoda, libra e partitura për t’i sjellë në Shkodër me qëllim që të zgjeronte organikën e orkestrës sinfonike. Në rastin konkret me këtë veprim Prenka me largpamësi mendonte që t’i shtonte ndonjë instrumentist tjetër dy fagotistëve të orkestrës Nino Saraçit dhe Tonin Zadejës që gjithnjë e më shpesh aktivizoheshin në detyra të tjera. Në veprimtaritë muzikore të Shtëpisë së Kulturës zuri rrënjë edhe miqësia ndërmjet dajës sim dhe Nino Saraçit. Kështu, vite më pas, kur unë në klasën e dytë fillore munda që të futem në Shkollën e Muzikës, ndërhyrja e dajës bëri që të kaloja në klasën e zotni Ninos.

Shkolla e Muzikës në atë kohë ndodhej në ndërtesën që më përpara kishte qenë shtëpia e Dan Hasanit. Ruaj ende sot të gjalla emocionet e asaj dite tek kapërceva pragun e portës dhe u futa tek ai oborr hijerëndë (nga jashtë, nga rruga nuk e di pse më kishte lënë si fëmijë një mbresë të tillë). Duke ngjitur shkallët u shfaq pamja e një burri të gjatë e të hajmë, me flokët pak të thinjur të prerë shkurt, me fytyrën e zgjatur në të cilën spikasin syzet me skelet të zi dhe mustaqet. Tek bëri një lëvizje me dorë më bënë përshtypje përmasat e pëllëmbëve që m’u dukën të stërmëdha. Pasi shkëmbeu disa fjalë me dajën, na ftoi në klasën e tij. Menjëherë sapo hyra në të vura re që në klasën e zotni Ninos mbretëronte rregulli dhe në mobilimin e saj ndihej edhe dora e tij. Në mure zinin vend portretet e figurave të shquara botërore të muzikës. Të vështronte ngultas e krenar Bethoveni, ëndërrues Shumani, disi melankonik Chopini. Dy portretet e tjerë i mësova më vonë që ishin të Rihterit [1] dhe fon Bylovit [2], emra që i dëgjoja për herë të parë. Bashkë me vështrimet e këtyre kolosëve që të shoqëronin nga muret, ndjeva nga afër vështrimin autoritar e njëkohësisht plot me dashuri të atij që do të ishte për disa vite me radhë mësuesi im i pianofortes, zotni Ninoja.

Në kohën kur ishte e detyrueshme edhe për fëmijët që t’i drejtoheshin të rriturve me fjalët “shok” apo “profesor”, Nino Saraçi hynte në radhën e atyre pak personave të privilegjuar që nga të tjerët vazhdonin të mbanin emërtimin tradicional shkodran “zotni”.

Nën udhëheqjen e tij u hap para meje rruga e vështirë e pianistit. Me këmbëngulje kërkonte që të më nguliste qysh në fillim rëndësinë e studimit serioz, me metodë. Asnjë orë mësimi nuk fillonte pa bërë më përpara për minuta të tëra shkallët, arpezhet, akordet, ushtrimet teknike për zhdërvjelltësinë e dorës e pavarësinë e gishtave të Hanonit [3], të Çernit [4] e të autorëve të tjerë. Shumë herë ka qëlluar që i ka kopjuar ato me dorën e tij në fletoret tona. Ishte këmbëngulës në kërkesat për studimin e teknikës si bazë e përgatitjes së çdo instrumentisti. Me shumë kulture dhe thellësi trajtonte veprat e repertorit: invencionet e Bahut, Sonatinat dhe Sonatat e Klementit, Moxartit, Haydnit e Bethovenit, pjesët nga albumet për fëmijë të Shumanit, Çajkovskit, etj., e deri ato të autorëve shqiptarë.

Po aq mjedis të ngrohtë do të arrinte të krijonte zotni Ninoja edhe në klasën e katit të dytë në godinën e re të Shkollës së Muzikës (aty ku gjendet edhe sot). Tek shkolla e re zotni Ninoja vinte gjithmonë me biçikletë që e linte të lidhur përballë dritares së klasës. Kaq shumë e shoqëronim me imagjinatën tonë këtë lidhje të pandarë të njeriut me mjetin saqë vështrimi drejt biçikletës ishte bërë për ne nxënësit një sinjal për praninë e tij në shkollë.

Për shumicën e popullsisë nuk ishte e lehtë të jetoje nën diktaturë e sidomos e vështirë ishte për “të prekurit” (siç quheshin në atë kohë ajo kategori njerëzish në të cilën bënim pjese edhe unë e zotni Ninoja). Megjithatë edhe në ato vite të rënda dëshira, zelli dhe ndërgjegja e shumë muzikantëve kërkonte që të bëhej muzikë, shumë mësues punonin me përkushtim për të formuar brezat e rinj të muzikantëve. Në vend që të diskutohej se si të përmbushej sa më mirë kjo detyrë fisnike që është misioni i çdo institucioni shkollor apo për problemet lidhur me ngritjen e cilësisë së mësimdhënies, në mbledhjet e mbyllura të organizatës bazë të Partisë do të diskutohej për autorët botërorë që nuk duheshin lejuar që të studjoheshin e të ekzekutoheshin, për biografite e mësuesve e të nxënësve, për pakënaqësitë e shprehura nëpër bisedat e korridoreve a të kafeneve, për barceletat e batutat djegëse plot humor kundër regjimit, për flokët e gjata e për pantallonat e gjëra. E masat ndëshkuese. Për ta kjo ishte e rëndësishme.

Në gjysmën e dytë të viteve '70 u dekretua largimi i zotni Ninos nga profesor i pianofortes principale (po shkruaj termin që përdorte ai) në pianist shoqëruar i klasës së kantos. Këtij lloji “deklasimi” i përkiste në mënyrë figurative edhe zbritja nga kati i dytë i sektorit të pianos në katin e parë, në krahun e majtë të të cilit ndodhej klasa e kantos. Në vështrim të parë ky ndryshim do të duhej të shkëpuste marrëdhëniet shumë të frytshme mësues-nxënës që kisha patur deri atëherë me zotni Ninon. Megjithë situatën e re të krijuar, me shembullin praktik të tij do të më jepte të tjera mësim të vlefshme për të ardhmen. Në kushtet e reja zotni Ninoja shpalosi aftësinë në leximin “a prima vista” të partiturave, muzikalitetin dhe raportet e qarta në shoqërimin pianistik, ishte kërkues në prova, transmetonte tek këngëtarët e rinj përvojën e tij.

Zotni Ninoja ka qenë për vite të tëra Koncertmaestër në Shtëpinë e Kulturës dhe pianist i Orkestrës Sinfonike të këtij institucioni. Veprimtari që ndonëse në mënyrë jo të drejtpërdrejtë kanë ndikuar në mënyrë ideale tek unë. E kam menduar këtë edhe atëherë kur më ka rastisur, pas shumë viteve, që të bëja pjesë në grupin e atyre muzikantëve që merreshin me përgatitjen e Korit të Shtëpisë së Kulturës dhe kur si tastierist kam marrë pjesë në Orkestrën Sinfonike.

Rreth një vit e gjysëm pas këtij ndryshimi të detyruar në karrierën e zotni Ninos, (kalimit të tij si pianist shoqëruar), do të dekretohej largimi im nga Shkolla e Muzikës. Për arsye politike nuk m'u dha e drejta që pas mbarimit të tetëvjeçares të vazhdoja shkollën e mesme aty. Zotni Ninos i erdhi keq për këtë dhe pa fjalë por me vështrimin shprehës dhe me zemër më ka inkurajuar që të vazhdoja dhe të mos tërhiqesha. Më ka bërë ndonjë vizitë në shtëpi, jemi takuar në rrugë, është gëzuar kur pas shumë viteve munda të marr pjesë dhe të fitoj në konkursin për pranim në Akademinë e Arteve në Tiranë. Më pas kam vazhduar studimet në Itali dhe nuk kam patur rastin që të bisedoj gjerë e gjatë me të.

Gjatë këtyre viteve shumë figura të dashura që kanë kontribuar në formimin tim profesional nuk rrojnë më. Ndjej mungesën e mësuesve të mi. Më mungojnë Çesk Ndreca, Kol Gjinaj, Nino Saraçi, Hydajete Kaftalli, Tonin Daija, Gjon Kapidani, Tonin Harapi, Simon Gjoni, Çesk Zadeja, Gjon Simoni. Ndaj tyre dhe ndaj mësuesve të tjerë të nderuar [5], që janë gjallë dhe i uroj që të kenë jetë të gjatë dhe shëndet të plotë, ndjehem borxhli.

Më vjen keq që nuk kam mundur t'i takoj kur u diplomova në Muzikë Korale dhe Dirigjim Kori, që nuk munda t'u them që u diplomova në Kompozicion, që nuk munda të ndaj gëzimin me ta kur u diplomova në Dirigjim Orkestre, që nuk munda t'i falenderoj kur u diplomova në Didaktikë Muzikore, që nuk munda t'u shpreh sa duhet mirënjohjen time të thellë sepse në këto arritje ka ndikuar shumë edhe puna e tyre.

Mirënjohjen dhe falenderimet ndaj mësuesve të mi të nderuar po i bëj sot publikisht i bindur se lart nga qielli, aty ku janë, do të jenë gëzuar shumë e më kanë përcjellë bekimin e tyre.

Palermo, dhjetor 2009.

[1] Svjatoslav Teofiloviç Richter (20.03.1915 – 01.08.1997) pianist ukrahinasi, një ndër pianistët legjendarë të shekullit të XX-të.

[2] Hans Guido von Bülow (08.01.1830 – 12.02.1894) dirigjent orkestre dhe pianist gjerman, nxënës i Listit, i konsideruar si dirigjenti më i madh i kohës së tij.

[3] Charles-Louis Hanon (02.07.1819 – 19.03.1900) pianist dhe kompozitor francez. Vepra e tij e njohur “Pianisti virtuoz” përdoret edhe sot në ushtrimet e teknikës pianistike.

[4] Carl Czerny (21.02.1791 – 15.07.1857) pianist, kompozitor dhe didakt austriak. Nxënës i Bethovenit dhe mësues i shumë muzikantëve ndër të cilët spikat emri i Listit. Iu dedikua didaktikës pianistike dhe shkroi më se 1000 etyde që edhe sot përbëjnë bazën teknike të mësimit të pianofortes.

[5] U jam mirënjohës dhe falenderoj pedagogun e nderuar Albert Papparisto që më udhëhoqi në punimet muzikologjike gjatë periudhës së studimit në Akademinë e Arteve në Tiranë dhe mësuesit e pedagogët që gjatë viteve më kanë dhënë mësim apo me të cilët kam patur kontakte: Marita Vuksani, Zyliha Çoçja, Adelina Grimci, Ridvan Karakaçi, Ilirjana Dema, Sandër Çefa, Tonin Zadeja, Ilir Polena, Zana Shuteriqi, etj